

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“LED ANGEL SERVICE” SHPK**

Ortaku i vetëm themelues:

- **Z. Leopoldo D’Angelo** , shtetas italian, i datëlindjes 31.01.1984, lindur në Napoli dhe banues ne Rrugen Oberdan Nr.37/B , Pozzuoli, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit italiane Nr. AY7833624.

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë **27.11.2023**, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**

*Emri*

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin **“LED ANGEL SERVICE” SHPK** Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

*Forma*

Shoqëria tregtare **“LED ANGEL SERVICE” SHPK** ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

*Zyra Qendrore*

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“LED ANGEL SERVICE” SHPK**, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqipëri.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

*Objekti i Veprimtarisë*

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është: Sherbim konsulence ne investime jashtë dhe brenda vendit, shitblerje e pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme, investimeve publike dhe private, sigurine e jetës dhe jo jetës, ne fushen e kerkime per studime investimesh, kerkime dhe analize tregu per investim, konsulence marketingu online-off-line, prodhimin shkrimin e publikimin libra revista studime skencore, konsulence financiare, konsulence politik, konsulence kinematografisë. Konsulence per llogarite demet e shaktuar ndaj te tretve, konsulence e investime strategjike dhe makroekonomike, konsulence ndertim-zbatim e mirembajtje rrjeti teknologjisë. Konsulence te softwareve te ndryshme dhe perdorimi i tyre. Konsulence ne



fushen e cibercrime. Konsulence marketingu dhe reklamimi. kerkimet e tregut, identifikimin e konkurrencës dhe gjetjen e konsumatoreve. Shitjen e hapësirave publicitare për publikimet e veta dhe për llogari të tjerë, edhe nëpërmjet agjencive dhe ose shoqërive të tjera, organizimin e konferencave, kongreseve, seminareve si dhe të gjitha aktivitetëve në lidhje me marketingun. Shoqëria mund të kryejë menaxhimin e buxheteve publicitare. Ndërmjetësimi në fushën e marketing online dhe offline, për blerje jashtë dhe brenda vendit për individ dhe biznese, menaxhim për llogari të tjerë e marrëdhëniet me publikun, ndërmjetësim për llogaritjen dhe rekuperimin e borxheve të keqija, ndërmjetësime legale për palet në konflikt ose jo.

**NENI 5**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 6**  
***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “LED ANGEL SERVICE” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**  
***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “LED ANGEL SERVICE” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

**NENI 8**  
***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “LED ANGEL SERVICE” SHPK është 100.000 (njqindmije) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakët i vetëm **Z. Leopoldo D’Angelo**.

**NENI 9**  
***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**  
***Administratori***

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është **Z. Leopoldo D’Angelo**.



**NENI 11**  
***Sekreti tregtar***

Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “LED ANGEL SERVICE” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**NENI 12**  
***Mosmarreveshjet***

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*Ky Akt u redaktua ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane, me vlere te njejte ligjore.*

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

Leopoldo D'Angelo

LEOPOLDO D'ANGELO

